

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. Hajrie Leka

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 3219 prot., datë 13.04.2023, ju sqarojmë se:

Nga data 1 maj 2022, në zbatim të VKM nr.252, datë 29.04.2022 "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre", të gjitha aplikimet për shërbimet që ofron Instituti i Sigurimeve Shoqërore realizohen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania.

Konkretisht për verifikimin e periudhave të vjetërsisë në punë, në varësi të periudhave të punësimit/sigurimit që keni realizuar, ju duhet të aplikoni me të dhëna të sakta, në portalin e - Albania, tek shërbimet elektronike si në vijim:

“Vërtetim për periudha pune në ish - kooperativat bujqësore (KB)”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për periudhat e punës në ish - kooperativat bujqësore.

“Vërtetim për periudha pune në ndërmarrje shtetërore para datës 01.01.1994”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për periudhat e punës në ndërmarrje shtetërore para datës 01.01.1994.

“Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 01.01.1994 deri 31.12.2011”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për periudhat e punës për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore si i punësuar, pas datës 01.01.1994.

“Vërtetim i pagesës së kontributeve të të vetëpunësuarve në bujqësi ose sigurim vullnetar 1993-2013”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për pagesën e kontributeve të të vetëpunësuarve në bujqësi ose vërtetimin e sigurimit vullnetar.

“Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore pas datës 01.01.2012”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore me vulë elektronike me vlerë të plotë ligjore.

Pas kryerjes së verifikimeve, vërtetimet gjenerohen on-line, brenda afateve zyrtare, tek opsioni "mesazhet e mia", në portalin e-Albania.

Bazuar në nenin 31, të ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: *personat e siguar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të po këtij ligji.*

Në zbatim të nenit 92, të ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me ligjin nr. 104, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në

ligjin nr. 7703/11.5.1993”, nga data 01.01.2015 vjetërsia e plotë e kërkuar për pension pleqërie si për gratë edhe për burrat shtohet në mënyrë graduale me nga 4 muaj çdo vit deri në vitin 2032.

Referuar kartës tuaj të identitetit me numër ID G25225015M, ju jeni e datëlindjes 25.02.1962 dhe sipas nenit 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e drejta për të përfituar pension pleqërie ju lind në datën 25.08.2023, në moshën 61 vjeç e 6 muaj dhe me vjetërsi të plotë 38 vite.

Nëse plotësoni kushtet e kërkuara në ligj, në momentin e plotësimit të moshës për pension duhet të aplikoni me kërkesën për caktim pensioni pleqërie. Aplikimi bëhet on-line në portalin e-Albania, tek shërbimi "Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundruës i nëndetëseve apo suplementar për akademik" në zbatim të neneve 31, 32, 92, 95, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993. Në këtë aplikim duhet të deklaroni saktë të gjitha periudhat e punësimit sipas ndërmarrjeve/subjekteve ku keni punuar.

Menjëherë pas aplikimit, dokumentat origjinale të pensionit së bashku me kopjen e aplikimit, duhet të dërgohen nëpërmjet shërbimit postar në adresë të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore të vendbanimit tuaj.

Strukturat Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, do të vlerësojnë dokumentacionin dhe do t’ju informojnë në lidhje me caktimin e pensionit brenda afateve zyrtare konform legjislacionit në fuqi.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.